



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada – Government*

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK)-NR. 01/2021**  
**PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E FËMIJËVE KRYERËS TË VEPRAVE PENALE NËN MOSHËN**  
**E PËRGJEGJËSISË PENALE<sup>1</sup>**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) - NO.01/2021**  
**ON PROTECTION AND TREATMENT OF CHILDREN AS OFFENDERS OF CRIMINAL OFFENCES**  
**UNDER THE AGE OF CRIMINAL RESPONSIBILITY<sup>2</sup>**

**ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (VRK) -BR. 01/2021**  
**O ZAŠTITI I TRETMANU DECE POČINIOCA KRIVIČNIH DELA ISPOD STAROSTI KRIVIČNE**  
**ODGOVORNOSTI<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale, është miratuar në mbledhjen e 58 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.03/58, datë 14.01.2021;

<sup>2</sup> Administrative Instruction (GRK) No. No. 01/2021 on protection and treatment of children as offenders of criminal offences under the age of criminal responsibility, was approved on 58 meeting of the Government of Kosovo, with the decision No.03/58, date 14.01.2021

<sup>3</sup> Administrativno Uputstvo (VRK) Br. 01/2021 o zaštiti i tretmanu dece počinioca krivičnih dela ispod starosti krivične odgovornosti, usvojen je na 58 sednicu Vlade Kosova, odlukom br. 03/58, datum 14.01.2021.

<p><b>Qeveria e Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në mbështetje të Nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Në pajtim me Nenin 8 (4) të Kodit nr. 06/L-006 të drejtësisë për të mitur (Gazeta Zyrtare, nr. 17 / 18 tetor 2018), duke marrë parasysh Nenin 11.A dhe Nenin 11.B të Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare nr. 12 / 01 maj 2007) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare / nr. 5 / 05 prill 2012), si dhe në pajtim me Nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, nr. 15 / 12 shtator 2011),</p> <p>Miraton:</p> <p><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK)-NR. 01/2021 PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E FËMIJËVE KRYERËS TË VEPRAVE PENALE NËN MOSHËN E PËRGJEGJËSISË PENALE</b></p> <p><b>KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p>	<p><b>The Government of the Republic of Kosovo,</b></p> <p>Pursuant to Article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, In accordance with Article 8 (4) of Juvenile Justice Code No. 06/L-006 (Official Gazette No. 17/18 October 2018), with regard to Article 11.A and Article 11.B of Law No. 02/L-17 on Social and Family Services (Official Gazette No. 12/01 May 2007), as amended and supplemented by Law No. 04/L-081 on amending and supplementing Law No. 02/L-17 on Social and Family Services (Official Gazette No. 5/5 April 2012) and in accordance with Article 19 (6.2) of Regulation No. 09/2011 of Rules and Procedure of the Government (Official Gazette No. 15/12 September 2011),</p> <p>Approves:</p> <p><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK)-NO. 01/2021 ON PROTECTION AND TREATMENT OF CHILDREN AS OFFENDERS OF CRIMINAL OFFENCES UNDER THE AGE OF CRIMINAL RESPONSIBILITY</b></p> <p><b>CHAPTER I - GENERAL PROVISIONS</b></p>	<p><b>Vlada Republike Kosovo,</b></p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosovo, U skladu sa članom 8 (4) Zakonika br. 06/L-006 pravde o maloletnicima (Službeni list, br. 17/18. oktobar 2018), uzimajući u obzir član 11. A i član 11. B Zakona br. 02/L-17 o socijalnim i porodičnim uslugama (Službeni list br. 12/01. maj 2007), izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-081 o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-17 o socijalnim i porodičnim uslugama (Službeni list, br. 5/05. april 2012) i u skladu sa članom 19 (6.2) Pravilnika o radu Vlade br. 09/2011 (Službeni list, br. 15/12. septembar 2011),</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (VRK) -NR. 01/2021 O ZAŠTITI I TRETMANU DECE POČINIOCA KRIVIČNIH DELA ISPOD STAROSTI KRIVIČNE ODGOVORNOSTI</b></p> <p><b>POGLAVLJE I - OPŠTE ODREDBE</b></p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Qëllimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 1 Purpose</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 1 Cilj</b></p>
<p>1. Me këtë Udhëzim Administrativ, për fëmijën kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale, përcaktohet:</p> <p>1.1. Mbrojtja; 1.2. programi i mbrojtjes; 1.3. ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve; 1.4. ndihma juridike dhe 1.5. trajtimi.</p>	<p>1. This Administrative Instruction on the child as offender of criminal offences under the age of criminal responsibility sets out:</p> <p>1.1. protection; 1.2. protection programme; 1.3. peer mediation;  1.4. legal assistance, and 1.5. treatment.</p>	<p>1. Ovim administrativnim uputstvom, o detetu počiniocu krivičnih dela, ispod starosti krivične odgovornosti, utvrđuje se:</p> <p>1.1. zaštita; 1.2. program zaštite; 1.3. posredovanje između vršnjaka;  1.4. pravna pomoć i 1.5. tretman.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p>
<p>Ky Udhëzim Administrativ:</p> <p>1.1. zbatohet nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe për të gjithë personat, në të gjitha fazat, për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur katërbëdhjetë (14) vjet, gjegjësisht për fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale.</p> <p>1.2. zbatohet për fëmijën me shtetësi kosovare, pa shtetësi, të pa regjistruar, azilkërkuar, refugjat ose me shtetësi të huaj, që kryejnë vepra penale</p>	<p>This Administrative Instruction:</p> <p>1.1. shall be enforced by all institutions of the Republic of Kosovo and shall apply to all persons, at all stages, for protection and treatment of the child, who at the time of committing the criminal offence has not reached fourteen (14) years old, namely for the child under the age of criminal responsibility.</p> <p>1.2. shall apply to children with Kosovar citizenship, stateless children, unregistered children, asylum-seeking children, refugee children or children of</p>	<p>Ovo Administrativno uputstvo:</p> <p>1.1. primenjuje se od strane svih institucija Republike Kosovo i za sva lica, u svim fazama, za zaštitu i tretmanu deteta, koje u vreme izvršenja krivičnog dela nije navršilo četrnaest (14) godina, za dete ispod starosti krivične odgovornosti.</p> <p>1.2. primenjuje se za dete sa kosovskim državljanstvom, bez državljanstva, neregistrovanom, tražiocem azila, izbeglicom ili sa stranim</p>

<p>brenda territorit të Republikës së Kosovës, dhe për fëmijën me shtetësi kosovare, që kryen vepra penale jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe ekstradohet në Republikën e Kosovës.</p> <p>1.3. duhet interpretuar dhe zbatuar brenda kuadrit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventës për të Drejtat e Fëmijës ose me instrumentet ndërkombëtare, që rregullojnë këtë fushë, Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, Kodit të Drejtësisë për të Mitur, Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.</p>	<p>foreign citizenship who commit criminal offences within the territory of the Republic of Kosovo, as well as children of Kosovar citizenship who commit criminal offences outside the territory of the Republic of Kosovo and are extradited to the Republic of Kosovo.</p> <p>1.3. shall be interpreted and implemented in the framework of the Constitution of the Republic of Kosovo, Convention on the Rights of the Child or international instruments governing this field, Law on Child Protection, Juvenile Justice Code, Law on Social and Family Services and the relevant applicable legislation.</p>	<p>državljanstvom, koja čine krivična dela u teritoriji Republike Kosovo, i za dete sa kosovskim državljanstvom, koje čini krivična dela van teritorije Republike Kosovo i izručen je u Republici Kosovo.</p> <p>1.3. mora se tumačiti i sprovoditi u okviru Ustava Republike Kosovo, Konvencije o pravima deteta ili međunarodnih instrumenata koji regulišu ovu oblast, Zakona o zaštiti deteta, Zakonika pravde o maloletnicima, Zakona o socijalnim i porodičnim uslugama i relevantnim važećim zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Përkufizimet</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>Definitions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3</b> <b>Definicije</b></p>
<p>1. Shprehjet e përdorura për qëllim të këtij udhëzimi administrativ kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Edukim i specializuar</b> - programi edukativ i përpiluar sipas nevojave speciale të kryerësit të veprës penale, i cili synon të ndihmojë zhvillimin e gjithmbarshëm adekuat të tij dhe të zvogëlojë mundësinë e përsëritjes së veprës;</p>	<p>1. Terms used for the purpose of this Administrative Instruction shall have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Specialised education</b> – an educational program tailored to the special needs of the offender, which seeks to assist his/her holistic adequate development and reduce the chance of recidivism;</p>	<p>1. Izrazi upotrebljeni za potrebe ovog Administrativnog uputstva imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. <b>Specijalno vaspitanje</b> - vaspitni program pripremljen prema specijalnim potrebama izvršioca krivičnog dela, koji teži pružanju pomoći za njegov valjani opšti razvoj i smanjenju verovatnoće ponavljanja dela;</p>

<p>1.2. <b>Fëmijë</b> - fëmija, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur katërmëdhjetë (14) vjet, pra është fëmijë nën moshën e përgjegjësisë penale;</p> <p>1.3. <b>Institucion</b> - nënkupton të gjitha institucionet publike, të nivelit qendror dhe lokal, si dhe personat e tjerë fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës, që kanë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>1.4. <b>Këshillim</b> - është një proces sistematik dhe i programuar i ofrimit të informacionit, këshillave dhe udhëzimeve me qëllim, që të ndihmohet një fëmijë nën moshën e përgjegjësisë penale për të përmirësuar rrethanat sociale dhe ndër njerëzore;</p> <p>1.5. <b>Kodi i drejtësisë për të mitur/Kodi</b> - Kodi nr. 06/L-006 i drejtësisë për të mitur; (Gazeta Zyrtare, nr. 17, 18 tetor 2018);</p> <p>1.6. <b>Konventa mbi të drejtat e fëmijës/Konventa</b> - Konventa mbi të drejtat e fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e</p>	<p>1.2. <b>Child</b> – the child who at the time of committing the criminal offence has not reached the age of fourteen (14) years, i.e. child under the age of criminal responsibility;</p> <p>1.3. <b>Institution</b> – means all public, central and local institutions, as well as other natural and legal persons in the Republic of Kosovo who are responsible for protection of the child according to the legislation in force;</p> <p>1.4. <b>Counselling</b> – means a systematic and programmed system of the provision of information, advice and instructions in order to help the child under the age of criminal responsibility to improve social inter-human circumstances;</p> <p>1.5. <b>Juvenile Justice Code/Code</b> – means the Juvenile Justice Code No. 06/L-006 (Official Gazette, No. 17, 18 October 2018);</p> <p>1.6. <b>Convention on the Rights of the Child/Convention</b> – means the Convention on the Rights of the Child</p>	<p>1.2. <b>Dete</b> –dete koje u vreme izvršenja dela nije navršilo četrnaest (14) godina, dakle ispod starosti krivične odgovornosti;</p> <p>1.3. <b>Institucija</b> – podrazumeva sve javne, centralne i lokalne institucije, kao i druga privatna pravna lica u Republici Kosovo, koja su odgovorna za zaštitu deteta u ovom Zakonu i važećem zakonodavstvu;</p> <p>1.4. <b>Savetovanje</b> - je sistematski i programirani proces pružanja informacija, saveta i smernica u cilju pomaganja deteta ispod starosti krivične odgovornosti radi poboljšanja socijalnih i ljudskih okolnosti;</p> <p>1.5. <b>Zakonik pravde o maloletnicima/Zakonik</b> - Zakonik br. 06/L-006 pravde o maloletnicima; (Službeni list, br. 17, 18. oktobar 2018);</p> <p>1.6. <b>Konvencija o pravima deteta/Konvencija</b> - Konvencija o pravima deteta koju je Generalna</p>
--	---	---

<p>Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989;</p> <p>1.7. <b>Kujdestar</b> - nënkupton personin siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 2004/32 për familjen (Gazeta Zyrtare nr. 4, 01 shtator 2006);</p> <p>1.8. <b>Ligji për mbrojtjen e fëmijës</b> - Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës; (Gazeta Zyrtare nr. 14, 17 korrik 2019);</p> <p>1.9. <b>Ligji për ndërmjetësim</b> - Ligji nr. 06/L-009 për ndërmjetësim (Gazeta Zyrtare nr. 14, 20 gusht 2018);</p> <p>1.10. <b>Ligji për ndihmë juridike falas</b>- Ligji nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas (Gazeta Zyrtare nr. 03, 22 shkurt 2012);</p> <p>1.11. <b>Ligji për shërbime sociale dhe familjare/Ligji</b> - Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare nr. 12, 01 maj 2007) dhe Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare, nr. 5, 05 prill 2012);</p>	<p>adopted by the General Assembly of the United Nations on 20 November 1989;</p> <p>1.7. <b>Guardian</b> – means the person as stipulated in Law No. 2004/32 Family Law (Official Gazette No. 4, 1 September 2006);</p> <p>1.8. <b>Law on Child Protection</b> – means Law No. 06/L-084 on Child Protection (Official Gazette No. 14, 17 July 2019);</p> <p>1.9. <b>Law on Mediation</b> – means Law No. 06/L-009 on Mediation (Official Gazette No. 14, 20 August 2018);</p> <p>1.10. <b>Law on Free Legal Aid</b> – means Law No. 04/L-017 on Free Legal Aid (Official Gazette No. 03, 22 February 2012);</p> <p>1.11. <b>Law on Social and Family Services/Law</b> – means Law No. 02/L-17 on Social and Family Services (Official Gazette No. 12, 01 May 2007) and Law No. 04/L-081 on amending and supplementing the Law No. 02/L-17 on Social and Family Services (Official Gazette, No. 5, 5 April 2012);</p>	<p>skupština Ujedinjenih nacija usvojila 20. novembra 1989. Godine;</p> <p>1.7. <b>Staratelj</b> – podrazumeva osobu kako je definisano Zakonom br. 2004/32 o porodici (Službeni list br. 4, 01. septembar 2006);</p> <p>1.8. <b>Zakon o zaštiti deteta</b> – Zakon br. 06/L-084 o zaštiti deteta; (Službeni list br. 14, 17. juli 2019);</p> <p>1.9. <b>Zakon o posredovanju</b> – Zakon br. 06/L-009 o posredovanju (Službeni list br. 14, 20. avgust 2018);</p> <p>1.10. <b>Zakon o besplatnoj pravnoj pomoći</b> – Zakon br. 04/L-017 o besplatnoj pravnoj pomoći (Službeni list br. 03, 22. februar 2012);</p> <p>1.11. <b>Zakon o socijalnim i porodičnim uslugama/Zakon</b> – Zakon br. 02/L-17 o socijalnim i porodičnim uslugama (Službeni list br. 12, 01. maj 2007) i Zakon br. 04/L-081 o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-17 o socijalnim i porodičnim uslugama (Službeni list, br. 5, 05. april 2012);</p>
---	---	---

<p>1.12. <b>Mbrojtësi i fëmijës</b> – Avokati, përfaqësues i autorizuar, mbrojtësi i licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës;</p> <p>1.13. <b>Menaxher i rastit</b> - nënkupton zyrtarin e licencuar të shërbimeve sociale, të caktuar nga Organi i Kujdestarisë, përgjegjës për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili në bashkëpunim me akterët relevantë vlerëson nevojat e fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale dhe harton Programin e mbrojtjes së fëmijës;</p> <p>1.14. <b>Ministria</b> - Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale;</p> <p>1.15. <b>Ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmohatarëve</b> - është një proces i ndërmjetësimit në mes të palëve, fëmijës kryerës i veprës penale dhe bashkëmohatarit të tij/saj në cilësinë e të dëmtuarit, në pajtim me parimet e ndërmjetësimit;</p> <p>1.16. <b>Ndihmë juridike falas</b> - e drejtë në shërbime profesionale juridike falas për fëmijët të cilët i plotësojnë</p>	<p>1.12. <b>Child Advocate</b> – Defence counsel, authorized representative, advocate licensed by the Kosovo Chamber of Advocates;</p> <p>1.13. <b>Case manager</b> – means the licensed officer of social services assigned by the Guardianship Authority to be responsible for the protection and treatment of the child offender of the criminal offence under the age of criminal responsibility, who, in cooperation with relevant stakeholders, assesses the needs of the child under the age of criminal responsibility and drafts the Child Protection Programme;</p> <p>1.14. <b>Ministry</b> – means the relevant Ministry for Labour and Social Welfare;</p> <p>1.15. <b>Peer mediation</b> – is a process of mediation between the parties, the child offender of criminal offence and his/her peer in the capacity of the injured party, in accordance with the mediation principles;</p> <p>1.16. <b>Free Legal Aid</b> – means the right to free professional legal services for children who fulfil the criteria set in the applicable legislation;</p>	<p>1.12. <b>Zaštitnik deteta</b> – Advokat, ovlašćeni zastupnik, zaštitnik licenciran od strane Advokatske komore Kosova;</p> <p>1.13. <b>Rukovodilac slučaja</b> - podrazumeva licenciranog službenika socijalnih usluga kojeg je odredio Organ starateljstva, odgovoran za zaštitu i tretman deteta počinioca krivičnih dela ispod starosti krivične odgovornosti, koji u saradnji sa relevantnim akterima procenjuje potrebe deteta ispod starosti krivične odgovornosti i izrađuje Program zaštite deteta;</p> <p>1.14. <b>Ministarstvo</b> – Relevantno ministarstvo za Rad i socijalnu zaštitu;</p> <p>1.15. <b>Posredovanje između vršnjaka</b> – podrazumeva proces posredovanja između stranaka, deteta počinioca krivičnog dela i njegovog/njenog vršnjaka u svojstvu oštećenog, u skladu sa principima posredovanja;</p> <p>1.16. <b>Besplatna pravna pomoć</b> - pravo na besplatne profesionalne pravne usluge za decu koja ispunjavaju</p>
--	---	--

<p>kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.17. <b>Në të gjitha fazat</b> - përfshin të gjitha procedurat në të cilat fëmija është në kontakt me institucionet përkatëse apo me profesionistët për mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.18. <b>Organi i Kujdestarisë</b> - nënkupton organin përgjegjës, që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës;</p> <p>1.19. <b>Përfaqësues ligjor</b>- nënkupton prindin ose personin, që ushtron autoritetin prindëror apo kujdestarin, i cili, brenda përgjegjësi, që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi nga gjykata, ose nga Organi i Kujdestarisë mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës;</p> <p>1.20. <b>Profesionistë për mbrojtjen e fëmijës</b> - nënkupton të gjithë personat, të cilët brenda mandatit të punës së tyre dhe në kontekstin e punës së tyre, janë në kontakt me fëmijën që ka nevojë për mbrojtje, ose kanë detyrë të përmbushin nevojat e</p>	<p>1.17. <b>At all stages</b> – includes all procedures in which the child is in contact with relevant institutions or child protection professionals;</p> <p>1.18. <b>Guardianship Authority</b> – means the responsible authority, operating within the Centre for Social Work, which is responsible for child protection;</p> <p>1.19. <b>Legal representative</b> – means the parent or the person who exercises the parental authority or the guardian, who, within the scope of responsibilities vested by the court or Guardianship Authority based on the applicable legislation, protects the interests of the child by performing or not legal actions on behalf or for the account of the child;</p> <p>1.20. <b>Child protection professionals</b> – means all persons who, within the mandate and in the context of their work, are in contact with the child who needs protection or are obliged to fulfil the needs of the child according to</p>	<p>kriterijume utvrđene važećim zakonodavstvom;</p> <p>1.17. <b>U svim fazama</b> - obuhvata sve postupke u kojima je dete u kontaktu sa relevantnim institucijama ili profesionalcima za zaštitu deteta;</p> <p>1.18. <b>Organ starateljstva</b> - podrazumeva odgovorno telo koje deluje u okviru Centra za socijalni rad nadležnog za zaštitu deteta;</p> <p>1.19. <b>Pravni zastupnik</b> - podrazumeva roditelja ili osobu koja vrši roditeljsku vlast ili staratelja koji, u okviru odgovornosti koje su mu dodeljene važećim zakonodavstvom od strane suda ili Organa starateljstva, štiti interese deteta izvođenjem ili ne, pravnih radnji, u ime ili za račun deteta;</p> <p>1.20. <b>Profesionalac za zaštitu deteta</b> – podrazumeva sva lica, koja su u okviru mandata svog rada i u kontekstu svog rada, u kontaktu sa detetom koji ima potrebu za zaštitom, ili im je dužnost da ispune potrebe deteta prema relevantnom</p>
--	--	--



<p>fëmijës sipas legjislacionit përkatës në fuqi, standardit vendor apo ndërkombëtar;</p> <p>1.21. <b>Programi i Mbrojtjes së Fëmijës</b> - Programi i mbrojtjes së fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale;</p> <p>1.22. <b>Prokuror i shtetit për të mitur</b> – prokuror i shtetit, i cili është ekspert në çështjet penale ku është i përfshirë i mituri, fëmija dhe madhori i ri, ndjekjen e kryerësve madhorë për veprat e kryera ndaj të miturve dhe i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësisë të parapara në Kod;</p> <p>1.23. <b>Qendra për Punë Sociale/QPS</b> - është institucion publik profesional i nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale;</p> <p>1.24. <b>Strehimi familjar</b> – është formë e veçantë e mbrojtjes sociale për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar ose lënë anash dhe nënkupton vendosjen e përkohshme të fëmijës në familjen tjetër atëherë kur</p>	<p>the relevant applicable legislation and local or international standards;</p> <p>1.21. <b>Child Protection Programme</b> – means the programme for protection of the child under the age of criminal responsibility;</p> <p>1.22. <b>Juvenile state prosecutor</b> – means a state prosecutor who has expertise in criminal matters involving the juvenile, children and young adults, prosecution of adult offenders for offences caused to juveniles, and who is competent to exercise the responsibilities set forth in the Code;</p> <p>1.23. <b>Centre for Social Work (CSW)</b> – means a public professional institution of the municipal level, which is competent for protection of citizens in social need;</p> <p>1.24. <b>Family foster care</b> – means a special form of social protection for children without parental care or who are abused or neglected and includes the temporary placement of the child in another family when the stay of the child</p>	<p>važećem zakonodavstvu, domaćeg ili međunarodnog standarda;</p> <p>1.21. <b>Program zaštite deteta</b> – Program zaštite deteta ispod starosti krivićne odgovornosti;</p> <p>1.22. <b>Državni tužilac za maloletnike</b> – državni tužilac koji je stručnjak za krivićna pitanja koja obuhvataju maloletne, decu i mlađa punoletna lica, gonjenje punoletnih poćinilaca za dela poćinjena protiv maloletnika i koji je nadležan da sprovodi odgovornosti predviđene u ovom Zakoniku;</p> <p>1.23. <b>Centar za socijalni rad/CSR</b> - je profesionalna javna institucija na opštinskom nivou, nadležna za zaštitu građana u socijalnoj nevolji;</p> <p>1.24. <b>Porodićni smeštaj</b> – je poseban oblik socijalne zaštite za decu bez roditeljskog staranja, koja su zlostavljena ili zanemarena i podrazumeva privremeni smeštaj deteta u drugu porodicu kada je boravak deteta u biološkoj porodici nemoguć;</p>
---	--	--

<p>qëndrimi i fëmijës në familjen biologjike është e pamundshme;</p> <p>1.25. <b>Strehimi rezidencial</b> - është formë e veçantë e mbrojtjes sociale për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar ose lënë anash dhe nënkupton vendosjen e fëmijës në institucionin përkatës të specializuar për strehim rezidencial;</p> <p>1.26. <b>Tryeza Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit</b> -nënkupton grupin multidisiplinar, që përfshinë profesionistët nga institucionet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës dhe akterët e tjerë që përfaqësojnë një shumëllojshmëri të disiplinave, të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës, ndër veprojnë dhe koordinojnë përpjekjet e tyre për të trajtuar rastet e fëmijës kryerës të veprës penale nën moshën e përgjegjësive penale në bazë të interesit më të mirë të fëmijës.</p>	<p>in his/her biological family is impossible;</p> <p>1.25. <b>Residential care</b> – a special form of social protection for children without parental care or who are abused or neglected and includes the placement of the child in the relevant institution specialized for residential care;</p> <p>1.26. <b>Multidisciplinary Roundtable for Assistance in Case Management</b> – means a multidisciplinary group that includes professionals from relevant child protection institutions and other stakeholders representing a variety of disciplines, who are responsible for child protection, interact and coordinate their efforts to handle cases of the child offenders of the criminal offence under the age of criminal responsibility based on the best interest of the child.</p>	<p>1.25. <b>Stambeni smeštaj</b> - je poseban oblik socijalne zaštite za decu bez roditeljskog staranja, koja su zlostavljena ili zanemarena i podrazumeva smeštaj deteta u relevantnoj instituciji specijalizovanoj za stambeni smeštaj;</p> <p>1.26. <b>Multidisciplinarni okrugli sto za pomoć u upravljanju slučajevima</b> – podrazumeva multidisciplinarnu grupu koja obuhvata stručnjake iz odgovarajućih institucija za zaštitu deteta i druge aktere koji zastupaju raznovrsnost disciplina, koji su odgovorni za zaštitu deteta, i koji međusobno deluju i koordiniraju njihova nastojanja za tretiranje slučajeva dece počinioca krivičnog dela, ispod starosti krivične odgovornosti, na osnovu najboljeg interesa deteta.</p>
---	---	--

<b>KAPITULLI II – PARIMET E MBROJTJËS SË FËMIJËS NËN MOSHËN E PËRGJEGJËSISË PENALE</b>	<b>CHAPTER II – PRINCIPLES OF PROTECTION OF CHILDREN UNDER THE AGE OF CRIMINAL RESPONSIBILITY</b>	<b>POGLAVLJE II - PRINCIPI ZAŠTITE DETETA ISPOD STAROSTI KRIVIČNE ODGOVORNOSTI</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Mos fillimi i procedurës gjyqësore</b></p> <p>1. Për fëmijën, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk e ka arritur moshën katërbëdhjetë (14) vjet, nuk mund të fillohet procedura gjyqësore.</p> <p>2. Prokurori për të mitur e pushon procedurën sapo të vërtetohet moshja e fëmijës.</p> <p>3. Nëse fëmija është nën moshën katërbëdhjetë (14) vjet në kohën e kryerjes së veprës penale, çdo procedurë gjyqësore, që ka filluar pushohet menjëherë dhe organi i kujdestarisë njoftohet për rastin nga policia pas konsultimit me prokurorin e shtetit për të mitur.</p> <p>4. Asnjë lloj dënimi nuk mund t'i shqiptohet fëmijës, i cili ka qenë nën moshën katërbëdhjetë (14) vjet në kohën e kryerjes së veprës penale.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Non-initiation of the court procedure</b></p> <p>1. No court proceedings shall be initiated for a child who has been under the age of fourteen (14) years old at the time of the commission of the offense.</p> <p>2. The Juvenile Prosecutor shall terminate the procedure after confirming the age of the child.</p> <p>3. If the child is under the age of fourteen (14) years when committing the criminal offence, any court procedure that has been initiated shall immediately be terminated and the Guardianship Authority shall be informed of this case by the police, following the consultations with the Juvenile State Prosecutor.</p> <p>4. No punishment may be imposed on a child who has been under the age of fourteen (14) years old at the time of the commission of the offense.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Ne pokretanje sudskog postupka</b></p> <p>1. Za dete, koje u vreme kada je počinjeno krivično delo nije navršilo četrnaest (14) godina, ne može se pokrenuti sudski postupak.</p> <p>2. Tužilac za maloletnike prekida postupak odmah nakon što se utvrdi starost deteta.</p> <p>3. Ako je u vreme izvršenja krivičnog dela dete mlađe od četrnaest (14) godina, svaki započeti sudski postupak će se odmah obustaviti, a Organ starateljstva o slučaju je obavešten od strane policije nakon konsultacije sa Državnim tužiocem za maloletnike.</p> <p>4. Nijedna kazna se ne može izreći detetu, koje je u vreme izvršenja krivičnog dela bilo ispod starosti od (14) godina.</p>

<p>5. Në asnjë rrethanë, fëmija, që merret në përkujdesje nga Organi i Kujdestarisë, nuk vendoset në një institucion ndëshkimor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Interesi më i mirë i fëmijës nën moshën e përgjegjesisë penale</b></p> <p>1. Të gjitha veprimet dhe vendimet, në të gjitha fazat, që kanë të bëjnë me fëmijën, të ndërmarra nga institucionet dhe nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës dhe interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.</p> <p>2. Interpretimi i interesave më të mira të fëmijës duhet të jenë në tërësi në përputhje dhe me respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre të parapara me Kushtetutën, Konventën ose me Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi drejtësinë mike të fëmijëve, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Kodin.</p> <p>3. Asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Kushtetuta, Konventa, Ligji për mbrojtjen e fëmijës,</p>	<p>5. Under no circumstances shall the child being taken care of by the Guardianship Authority be placed in a detention institution.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Best interest of the child under the age of criminal responsibility</b></p> <p>1. All actions and decisions, at all stages, related to the child and taken by the child protection institutions and professionals shall be in the best interest of the child and the highest interest of the child should be the overriding consideration.</p> <p>2. Interpretation of the best interests of the child shall entirely comply with the observance of their rights and freedoms provided for in the Constitution, Convention or the Guidelines of the Council of Europe on child-friendly justice, Law on Child Protection, Law on Social and Family Services and the Code.</p> <p>3. No purported interpretation of what is in the best interest of the child can justify the violation of any rights recognized in the Constitution, Convention, Law on Child</p>	<p>5. Ni pod kojim okolnostima, dete koje je uzeto pod starateljstvo Organa starateljstva, ne može se smestiti u kaznenu instituciju.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Najbolji interes deteta ispod starosti krivične odgovornosti</b></p> <p>1. Sve radnje i odluke u svim fazama koje se odnose na dete, koje su preduzele institucije i profesionalci za zaštitu deteta biće u najboljem interesu deteta i najviši interes deteta treba biti preovladajuća briga.</p> <p>2. Tumačenje najboljih interesa deteta treba u potpunosti biti u skladu sa i sa poštovanjem njihovih prava i sloboda utvrđenih Ustavom, Konvencijom ili sa uputstvima Saveta Evrope o prijateljskoj dečijoj pravdi, Zakonom o zaštiti deteta, Zakonom za socijalne i porodične usluge i Zakonikom.</p> <p>3. Nijedno navodno tumačenje onoga što je u najboljem interesu deteta ne može opravdati kršenje bilo kog prava priznatog Ustavom, Konvencijom, Zakonom o zaštiti deteta,</p>
---	---	--

<p>Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Kodi.</p> <p>4. Ndërhyrja zyrtare duhet të jetë e orientuar në interesat më të mira të fëmijës dhe të zbatohen me përpikëri dhe barazi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Parimi i trajtimit të barabartë</b></p> <p>1. Të gjithë fëmijët, duhet të trajtohen në të gjitha fazat në mënyrë të barabartë.</p> <p>2. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilido nga bazat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.</p> <p>3. Të gjitha institucionet dhe të gjithë profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, në të gjitha fazat, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit, duhet të veprojnë në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të fëmijës dhe të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim, që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit.</p>	<p>Protection, Law on Social and Family Services and Code.</p> <p>4. Official intervention shall be oriented towards the best interests of the child and shall be accurately and equally implemented.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Principle of equal treatment</b></p> <p>1. All children shall be equally treated at all stages.</p> <p>2. Principle of equal treatment means that there will be no direct or indirect discrimination within the meaning of any of the bases set out in the relevant provisions of the Law on Protection from Discrimination.</p> <p>3. All child protection institutions and professionals, at all stages, when exercising their duties and when drafting policies and legislation, shall comply with the principle of equal treatment of the child and shall take all necessary measures in order for the child to be protected from all forms of discrimination.</p>	<p>Zakonom o socijalnim i porodičnim uslugama i Zakonikom.</p> <p>4. Zvanična intervencija mora biti usmerena na najbolje interese deteta i biti sprovedena tačno i pravično.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Princip jednakog tretmana</b></p> <p>1. Sva deca trebaju biti tretirana podjednako u svim fazama.</p> <p>2. Princip jednakog tretmana znači da neće biti direktne ili indirektne diskriminacije u smislu bilo koje osnove utvrđene u relevantnim odredbama Zakona o zaštiti od diskriminacije.</p> <p>3. Sve institucije i svi profesionalci za zaštitu deteta u svim fazama, tokom vršenja svojih dužnosti i tokom izrade politika i zakonodavstva, treba da postupaju u skladu sa principom jednakog tretmana deteta i preduzmu sve potrebne mere za osiguranje da dete bude zaštićeno od svih oblika diskriminacije.</p>
---	---	---

<p>4. Institucionet dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojnë grupeve të fëmijëve, të cilët bien në konflikt me ligjin dhe u përkasin grupeve të ndryshme shoqërore apo komuniteteve të caktuara.</p> <p>5. Institucionet dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të marrin masa për parandalimin e diskriminimit, duke i siguruar fëmijëve, mbështetjen e nevojshme në përpjekjet e tyre për t'u ri integruar në shoqëri.</p> <p>6. Prindi apo kujdestari, anëtarët e familjes, personi i besueshëm, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, Avokati i Popullit, të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale, mund të iniciojnë procedurë dhe paraqesin fakte para organit kompetent, në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.</p>	<p>4. Child protection institutions and professionals shall pay special attention to the groups of children who are in conflict with the law and belong to various social groups or certain communities.</p> <p>5. Child protection institutions and professionals shall take measures to prevent discrimination by providing children with the necessary support in their efforts for integration into society.</p> <p>6. The parent or the guardian, members of the family, trusted person, child protection professionals or the Ombudsperson may initiate a procedure and provide facts before the competent body in compliance with the provisions of the Law on Protection from Discrimination if they consider that the principle of equal treatment has not been applied for a child under the age of criminal responsibility.</p>	<p>4. Institucije i profesionalci za zaštitu deteta treba da posvete posebnu pažnju grupama dece koja su u sukobu sa zakonom i pripadaju različitim društvenim grupama ili određenim zajednicama.</p> <p>5. Institucije i profesionalci za zaštitu deteta treba da preduzmu mere za sprečavanje diskriminacije, osigurajući deci potrebnu podršku u njihovim naporima da se reintegrišu u društvo.</p> <p>6. Roditelj ili staratelj, članovi porodice, poverljiva osoba, profesionalci za zaštitu deteta, Ombudsman, koji smatraju da se princip jednakog tretmana nije sproveden nad detetom ispod starosti krivične odgovornosti, mogu pokrenuti postupak i podneti činjenice pred nadležnim organom, u skladu sa odredbama Zakona o zaštiti od diskriminacije.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Parimi me familjen dhe partnerët për fëmijën</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>The principle with the family and partners for the child</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Princip sa porodicom i partnerima o detetu</b></p>
<p>1. Gjatë gjithë procesit të punës dhe në të gjitha fazat Menaxheri i rastit duhet të punojë sipas parimit:</p>	<p>1. Throughout the work process and at all stages the case manager shall work pursuant to the principle:</p>	<p>1. Tokom celog radnog procesa i u svim fazama Rukovodilac slučaja treba da radi prema principu:</p>

<p>1.1. Një Familje, Një Program, Një punonjës, Një ekip.</p> <p>1.2. Me familjen dhe për familjen. Me partnerët dhe familjen për fëmijën.</p> <p>2. Departamenti përkatës i Ministrisë nxjerrë udhëzues për zbatimin e parimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni.</p> <p><b>KAPITULLI III - MËNYRA E MBROJTJES SË FËMIJËVE KRYERËS TË VEPRAVE PENALE NËN MOSHËN E PËRGJEGJËSISË PENALE</b></p> <p><b>Neni 8</b> <b>Ndalimi i fëmijës nën moshën e përgjegjësive penale</b></p> <p>1. Në parim fëmiju kur ndalohet të gjitha veprimet duhet të ndërmerren në ndonjë ambient konform qasjes miqësore dhe që shmang stigmatizimin e tij duke e dërguar atë në stacion policor.</p>	<p>1.1. One Family, One Program, One Employee, One Team.</p> <p>1.2. With family and for family. With partners and family for the child.</p> <p>2. The relevant department of the Ministry issues guidelines for the implementation of the principle set out in paragraph 1 of this Article.</p> <p><b>CHAPTER III – MANNER OF PROTECTION OF CHILDREN AS OFFENDERS OF CRIMINAL OFFENCES UNDER THE AGE OF CRIMINAL RESPONSIBILITY</b></p> <p><b>Article 8</b> <b>Arrest of the child under the age of criminal responsibility</b></p> <p>1. In principle, when a child is arrested, all actions shall be taken in an environment that is in compliance with a friendly approach and that prevents his/her stigmatization by sending him/her to a police station.</p>	<p><b>1.19</b> jedna porodica, jedan program, jedan zaposleni, jedan tim.</p> <p><b>1.20</b> sa porodicom i za porodicu. Sa partnerima i porodicom za dete.</p> <p>2. Odgovarajuće Odeljenje Ministarstva izdaje uputstvo za sprovođenje principa utvrđenog u stavu 1. ovog člana.</p> <p><b>POGLAVLJE III- NAČIN ZAŠTITE DECE POČINIoca KRIVIČNIH DELA ISPOD STAROSTI KRIVIČNE ODGOVORNOSTI</b></p> <p><b>Član 8</b> <b>Zadržavanje deteta ispod starosti krivične odgovornosti</b></p> <p>1. U principu, kada se dete privede, svi postupci se moraju preduzeti u okruženju koje je u skladu sa prijateljskim pristupom i koje izbegava njegovu stigmatizaciju slanjem u policijsku stanicu.</p>
--	---	--

<p>2. Fëmija në rrethana normale dërgohet në QPS, në ndonjë ambient te vecantë në shkollë, familje, Shtëpinë për Mbrojtjen e Fëmijës apo ndonjë ambient tjetër gjatë procesit të vërtetimit të moshës dhe zbulimit të rrethanave dhe marrjës së informatave relevante nga fëmija.</p> <p>3. Hapi më i rëndësishëm dhe shumë urgjent është konstatimi i moshës së fëmijës dhe konform moshës ndërmerren veprimet e mëtutjeshme.</p> <p>4. Ndalimi i fëmijës dhe dërgimi i tij në një stacion policor, përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër të mundshme, ku në këto raste ambienti duhet të jetë miqësorë dhe ndaras nga të rriturit.</p> <p>5. Transporti i fëmijës deri në stacionin policor, i dyshuar për kryerje të veprës penale, duhet të bëhet në kushte të përshtatshme duke marrë parasysh moshën e fëmijës dhe nuk duhet të bëhet transportimi me të rritur.</p> <p>6. Çdo fëmijë i ndaluar duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin, që i takon dinjitetit të njeriut duke u bazuar në nevojat specifike të personave të moshës së tij.</p>	<p>2. In normal circumstances, the child is sent to the CSW, in a special environment in school, family, Home for Child Protection or any other environment during the process of verifying the age and discovering the circumstances and obtaining relevant information from the child.</p> <p>3. The most important and very urgent step is to ascertain the age of the child and, in accordance with the age, undertake further actions.</p> <p>4. Arresting a child and sending him/her to a police station shall be used only as a last resort and for the shortest time, while the environment in such cases shall be friendly and separate from adults</p> <p>5. Transport of the child, suspected of having committed a criminal offence, to the police station shall be made in appropriate conditions taking into account the age of the child and the child shall not be transported together with adults.</p> <p>6. Every child arrested shall be treated in a humane manner with respect for his/her human dignity and with considerations of the specific needs of persons of his/her age.</p>	<p>2. Dete se u normalnim okolnostima šalje u CSR, u nekom posebnom ambijentu u školi, porodici, Domu za zaštitu deteta ili u nekom drugom ambijentu tokom procesa utvrđivanja uzrasta i otkrivanja okolnosti i uzimanja relevantnih informacija od deteta.</p> <p>3. Najznačajniji i veoma hitan korak je utvrđivanje uzrasta deteta i u skladu sa uzrastom se preduzimaju dalji koraci.</p> <p>4. Zadržavanje deteta i njegovo privođenje u policijsku stanicu, upotrebljava se se samo kao krajnja mera i za što je moguće kraće vreme, pri čemu u ovim slučajevima ambijent treba da bude prijateljski i odvojen od odraslih.</p> <p>5. Prevoz deteta do policijske stanice, osumnjičenog da je počinio krivično delo, vrši se u prikladnim uslovima uzimajući u obzir uzrast deteta i ne sme se vršiti prevoz sa odraslima.</p> <p>6. Svako zadržano dete se tretira na ljudski način i uz dužno poštovanje dostojanstva ljudskog bića, tako da se uzimaju u obzir potrebe osoba njegovog uzrasta.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>E drejta për të pasur pranë prindin ose kujdestarin</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>The right for the presence of the parent or guardian</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Pravo da roditelj ili staratelj bude pored</b></p>
<p>1. Pas ndalimit të fëmijës nga policia, i dyshuar për kryerje të veprës penale, njoftohen menjëherë prindi ose kujdestari, dhe kur nuk është i mundur të bëhet njoftimi i menjëhershëm i tyre, ose do të ishte i dëmshëm për interesat e fëmijës, apo shprehimisht refuzohet nga fëmija, policia e lajmëron Qendrën për Punë Sociale. Kjo e drejtë e fëmijës është një detyrim për policinë.</p> <p>2. Prindi dhe kujdestari, me qëllim, që t'i ofrojnë fëmijës mbështetje duhet të njoftohen menjëherë për ndalimin e fëmijës, vendin e ndalimit dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit dhe duhet të jenë pranë fëmijës gjatë gjithë kohës. Ky obligim zbatohet në kuadër të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.</p> <p>3. QPS njoftohet në secilin rast kur ndalohet një fëmijë si i dyshuar për kryerje të veprës penale.</p>	<p>1. After the child suspected of having committed a criminal offence is arrested by the police, the parent or the guardian shall be immediately informed and when they cannot be immediately informed, or their information would be harmful for the interests of the child, or is expressly rejected by the child, the police shall inform the Centre for Social Work. This right of the child shall be an obligation for the police.</p> <p>2. The parent and the guardian, in order to provide support for the child, shall be immediately informed of the arrest of the child, place of arrest and any later change of the place of the arrest and should be with the children at all times. This obligation shall be implemented in the framework of the principle of the highest interest of the child.</p> <p>3. CSW shall be informed in any case when a child suspected of having committed a criminal offence is arrested.</p>	<p>1. Nakon pritvaranja deteta od strane policije, osumnjičenog da je počinio krivično delo, roditelj ili staratelj biće odmah obavješteni, i kada nije moguće obavestiti ih odmah ili bi to bilo štetno za interese deteta, ili dete izričito odbija, policija obavestava Centar za socijalni rad. Ovo pravo deteta je obaveza za policiju.</p> <p>2. Roditelj i staratelj, kako bi pružili podršku detetu, biće odmah obavješteni o detetovom pritvoru, mestu pritvora i svim naknadnim promenama mesta pritvora i moraju biti pored deteta tokom celog vremena. Ova obaveza se sprovodi u okviru principa najboljeg interesa deteta.</p> <p>3. CSR će biti obavješten u svakom slučaju kada se jedno dete osumnjičeno da je počinilo krivično delo pritvara.</p>

<p align="center"><b>Neni 10</b> <b>Pranimi, regjistrimi, lëvizja dhe transferimi</b></p>	<p align="center"><b>Article 10</b> <b>Admission, registration, movement and transfer</b></p>	<p align="center"><b>Član 10</b> <b>Prijem, registracija, pomeranje i transfer</b></p>
<p>1. Menjëherë pas dërgimit në stacion policor për secilin fëmijë duhet të merren parasysh statusi dhe nevojat e tyre të veçanta, në pajtim me moshën, personalitetin, gjininë dhe nivelin e cenueshmërisë, si dhe shëndeti mental dhe fizik dhe që, siguron mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme dhe situatat e rrezikshme. Në këto raste duhet pasur kujdes mbrojtjen e integritetit fizik, mental dhe moral si dhe mirëqenien e fëmijës.</p> <p>2. Në çdo stacion policor fëmijët duhen mbajtur ndaras nga të rriturit, përderisa nuk janë të së njëjtës familje.</p> <p>3. Njoftimi për pranim, duhet të sigurohet pa vonesë për prindin apo kujdestarin dhe për QPS-në.</p> <p>4. Pas regjistrimit dhe marrjes së informatave relevante në prani të prindit apo kujdestarit dhe zyrtarit të shërbimeve sociale, bëhet lirimi i fëmijës. Lirimi i fëmijës gjithnjë duhet të bëhet nën përcjelljen e prindit apo kujdestarit dhe në mungesë të tyre të zyrtarit të shërbimeve sociale të QPS-së.</p>	<p>1. Immediately after committal to the police station, every child's status and special needs in compliance with the age, personality, gender and level of vulnerability, and mental and physical health shall be considered and protection from harmful impacts and dangerous situations shall be ensured. In such cases, care shall be provided to the protection of physical, mental and moral integrity and child welfare.</p> <p>2. At any police station children shall be held separately from adults, unless they belong to the same family.</p> <p>3. Information on admission shall be provided to the parent or the guardian and CSW without delay.</p> <p>4. Following registration and after obtaining relevant information in the presence of the parent or the guardian and social services official, the child shall be released. The child shall always be released accompanied by the parent or guardian and in their absence, accompanied by the social services official of CSW.</p>	<p>1. Neposredno nakon slanja u policijsku stanicu za svako dete moraju se uzeti u obzir status i njihove posebne potrebe, u skladu sa njihovom starošću, ličnošću, polu i stepenu ugroženosti, kao i mentalno i fizičko zdravlje i osiguraju se zaštita od štetnih uticaja i opasnih situacija. U tim slučajevima treba voditi računa da se zaštiti fizički, mentalni i moralni integritet i dobrobit deteta.</p> <p>2. U svakoj policijskoj stanici decu treba držati odvojeno od odraslih, sve dok nisu iz iste porodice.</p> <p>3. Obaveštenje o prijemu, mora se bez odlaganja obezbediti za roditelja ili staratelja i za CSR.</p> <p>4. Nakon registracije i uzimanja relevantnih informacija u prisustvu roditelja ili staratelja i službenika socijalne službe, dete će biti oslobođeno. Oslobođanje deteta uvek mora da se vrši pod pratnjom roditelja ili staratelja i u njihovom odsustvu u pratnji službenika socijalne službe CSR-a.</p>

<p>5. Njoftimi për lirim dhe kopja e dosjes së shënimeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet QPS-së përkatëse.</p>	<p>5. Information on release and copy of the files with records stipulated in paragraph 3 of this article shall be submitted to the relevant CSW.</p>	<p>5. Obaveštenje o oslobađanju i kopija dosijea iz stava 3. ovog člana šalju se u relevantnom CSR-u.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Marrja e informatave relevante nga fëmija</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Obtaining relevant information from the child</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Uzimanje relevantnih informacija od deteta</b></p>
<p>1. Gjatë marrjës së informatave relevante, fëmiju duhet të trajtohen në një mënyrë të përshtatshme për moshën, pjekurinë dhe nivelin e kuptueshmërisë së tyre, duke marrë parasysh nevojat e veçanta, në çdo vështirësi komunikimi që mund të kenë.</p>	<p>1. While obtaining relevant information from the child, the child shall be treated in a manner appropriate to their age, maturity and level of understanding, taking into account any special needs, including any communication difficulties that they may have.</p>	<p>1. Prilikom uzimanja relevantnih informacija, decu treba tretirati na način koji je prikladan njihovoj starosti, zrelosti i stepenu razumevanja, uzimajući u obzir posebne potrebe, u svim teškoćama u komunikaciji koje mogu imati.</p>
<p>shëndetësore, për mbrojtjen e interesave të fëmijës.</p> <p>2. Për fëmijët kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësive penale, pas njoftimit nga prokurori, Organi i Kujdestarisë përgjegjës sipas kompetencës territoriale, ofron mbrojtje dhe trajtim adekuat dhe cakton Menaxherin e rasti.</p> <p>3. Organi i Kujdestarisë dhe Menaxheri i rasti ka për detyrë të përkujdeset dhe është i obliguar të veprojë çdoherë si prind i mirë ndaj fëmijës.</p> <p>4. Prindi ose kujdestari kanë të drejtë ta shoqërojnë fëmijën në të gjitha procedurat dhe në të gjitha fazat që zhvillohen nga Organi i Kujdestarisë dhe njëkohësisht nga ata kërkohet që të marrin pjesë nëse kjo është në interes të fëmijës.</p> <p>5. Kur prindi ose kujdestari nuk i kryejnë detyrat e tyre ndaj fëmijës, organi i kujdestarisë me pëlqimin e prindit apo kujdestarit mund të caktojë kujdestar të përkohshëm për fëmijën, ndërsa në rastet kur nuk ka një pëlqim apo mospajtim gjykata mund të caktojë kujdestar të përkohshëm për fëmijën.</p>	<p>educational and health services for the protection of the child's interests.</p> <p>2. For child offenders under the age of criminal responsibility, the competent Guardianship Authority shall, upon notification by the prosecutor, provide adequate protection and treatment under its territorial authority and shall appoint a case manager.</p> <p>3. The Guardianship Authority and Case Manager shall be obliged to provide care and to act as a good parent to the child at all times.</p> <p>4. The parent or guardian shall have the right to accompany the child in all proceedings and at all stages carried out by the Guardianship Authority, and shall at the same time be required to attend if this is in the child's best interest.</p> <p>5. Where the parent or guardian fails to perform their duties towards the child, the Guardianship Authority may, at the consent of the parent or of the guardian, appoint a temporary guardian for the child, whereas in cases where there is no consent or there is disagreement, the court may appoint a temporary guardian for the child.</p>	<p>obrazovne i zdravstvene usluge za zaštitu interesa deteta.</p> <p>2. Za decu izvršioca krivičnih dela ispod starosti krivične odgovornosti, nakon obaveštenja od strane tužioca, Organ starateljstva odgovoran prema svojoj teritorijalnoj nadležnosti pruža odgovarajuću zaštitu i tretman i određuje Rukovodioca slučaja.</p> <p>3. Organ starateljstva i Rukovodilac slučaja su dužni da se brinu i obavezni su da uvek postupaju kao dobar roditelj deteta.</p> <p>4. Roditelj ili staratelj ima pravo da prati dete u svim postupcima i u svim fazama koje sprovodi Organ starateljstva, i istovremeno od njih se zahteva da prisustvuju ukoliko je to u najboljem interesu deteta.</p> <p>5. Kada roditelj ili staratelj ne izvrši svoje dužnosti prema detetu, Organ starateljstva uz odobrenje roditelja ili staratelja može odrediti odrediti privremenog staratelja za dete, a u slučajevima kada nema odobrenja ili postoji neslaganje, sud može odrediti privremenog staratelja za dete.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Mbrojtja e fëmijës nën moshën e përgjegjësishë penale në situata urgjente</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>Protection of children under the age of criminal responsibility in emergency situations</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 24</b> <b>Zaštita deteta ispod starosti krivične odgovornosti u hitnim situacijama</b></p>
<p>1. Në raste urgjente, jo më vonë se njëzet e katër (24) orë nga pranimi i informimit ose vënies në dijeni rreth kryerjes së ndonjë veprë penale të rëndë ose veprave të përsëritura, policia pas konsultimit me prokurorin e shtetit për të mitur e informon dhe kërkon nga organi i kujdestarisë ndërmarrjen e masave urgjente adekuate për trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijës.</p> <p>2. Kjo masë urgjente e ndihmës përfundon në momentin kur organi i kujdestarisë përpilon programin e mbrojtjes për fëmijën.</p> <p>3. Nëse një zyrtar i shërbimeve sociale ka arsye të bazuar se në një rast të caktuar ekziston rrezik serioz, imediat për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e një fëmije, ai mundet sipas kompetencave që ka, të hyjë në çdo objekt banimi dhe të vendosë fëmijën në një vend të sigurt, ku i ofrohet përkujdesja për një periudhë të caktuar, jo më të gjatë se shtatëdhjetë e dy orë (72).</p>	<p>1. In emergency cases, the Police shall, no later than twenty-four (24) hours after receipt of information or notification of the commission of any serious criminal offense or recurrent offenses, after consulting the State Prosecutor for Juveniles, inform and request from the Guardianship Authority to take adequate emergency measures for protecting and treating the child.</p> <p>2. Such emergency assistance measures shall end when the Guardianship Authority develops a child protection program.</p> <p>3. If a social services officer has reasonable grounds to believe that in a given case there is a serious immediate risk to the health, safety and well-being of a child, he may within his competences enter any residential premises and place the child in a safe place, where care is provided for a specified period not exceeding seventy-two hours (72).</p>	<p>1. U hitnim slučajevima, najkasnije dvadeset četiri (24) sata nakon prijema informacija ili davanja do znanja o izvršenju nekog teškog krivičnog dela ili ponovljenih dela, policija nakon konsultacija sa državnim tužiocem za maloletnike, obaveštava i zahteva od Organa starateljstva da preduzmu mere za odgovarajući tretman i zaštitu deteta.</p> <p>2. Ova hitna mera pomoći se završava u trenutku kada Organ starateljstva sastavlja program zaštite deteta.</p> <p>3. Ukoliko službenik socijalnih službi ima razumne razloge da veruje da u datom slučaju postoji neposredna ozbiljna opasnost, po zdravlje, bezbednost i dobrobit deteta, može da po ovlašćenjima koje ima uđe u bilo koji stambeni objekat i smesti dete na bezbednom mestu, gde se pruža nega tokom određenog perioda od najviše sedamdeset i dva (72) sata.</p>

<p>4. Para se të skadojë afati prej shtatëdhjetë e dy (72) orësh, nëse Organi i Kujdestarisë nuk siguron pëlqimin e prindit ose kujdestarit, rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Kur rrethanat e kërkojnë, gjykata mund t'i japë urdhër Organit të Kujdestarisë për vlerësim brenda një periudhe prej njëzetënjë (21) ditësh, për të mundësuar hetime të mëtejshme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Roli i komunës në mbrojtjen e fëmijës në situata urgjente</b></p> <p>1. Secila komunë brenda territorit të saj është përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve dhe masave mbrojtëse për mbrojtjen e fëmijës në situata urgjente, sipas standardeve dhe politikave përkatëse.</p> <p>2. Komunitat duhet të marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të tyre apo të bashkëpunojnë me komunitat përkatëse për realizimin e mbrojtjes urgjente.</p>	<p>4. Before the expiry of the seventy-two (72) hour period, if the Guardianship Authority does not secure the consent of the parent or guardian, the case shall be referred to the competent court to decide on the custody of the child. When circumstances so warrant, the court may order the Guardianship Authority to perform an assessment within twenty-one (21) days to enable further investigation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Municipality's role for child protection in emergency situations</b></p> <p>1. Each municipality shall be responsible to provide within its territory services and protection measures for child protection in emergency situations in accordance with relevant standards and policies.</p> <p>2. Municipalities shall take steps to identify the nature and extent of the need for child protection within their territory or to cooperate with relevant municipalities to implement urgent protection.</p>	<p>4. Pre isteka roka od sedamdeset dva (72) sata, ukoliko Organ starateljstva ne obezbeđuje saglasnost roditelja ili staratelja, slučaj treba prijaviti nadležnom sudu koji odlučuje o starateljstvu nad detetom. Kada okolnosti to zahtevaju, sud može dati nalog organu starateljstvu za procenu u roku od dvadeset i jednog (21) dana, kako bi se omogućila dalja istraga.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Uloga opštine u zaštiti deteta u hitnim slučajevima</b></p> <p>1. Svaka opština u svojoj teritoriji je odgovorna za pružanje usluga zaštite i zaštitne mere za zaštitu deteta u hitnim slučajevima u skladu sa odgovarajućim standardima i politikama.</p> <p>2. Opštine bi trebale da preuzmu korake za prepoznavanje prirode i dimenzije potrebe za zaštitu deteta na njihovoj teritoriji ili da sarađuju sa odgovarajućim opštinama radi realizacije hitne zaštite.</p>
--	---	--

<p><b>KAPITULLI IV – DETYRAT DHE PËRGJEGJËSISTË E MENAXHERIT TË RASTIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS NËN MOSHËN E PËRGJEGJËSISË PENALE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Caktimi i Menaxherit të Rastit për mbrojtjen e fëmijës nën moshën e përgjegjësive penale</b></p> <p>1. Për secilin fëmijë caktohet Menaxheri i Rastit, i cili duhet të jetë punonjës i QPS të komunës përkatëse ku ka vendbanimin apo vendndodhjen fëmija.</p> <p>2. Pas vlerësimit të rastit, Menaxheri i Rastit mund të krijojë partneritet me organizatat qeveritare dhe joqeveritare, institucionet shkollore, shëndetësore, policore, me familjen dhe komunitetin, në mënyrë që të krijohen mundësi sa më të mira për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës, dhe të punojë në bazë të parimit të përcaktuar në Nenin 7 të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>3. Menaxheri i rastit, gjatë përgatitjes së Programit të Mbrojtjes së Fëmijës, ndër të tjera duhet të:</p>	<p><b>CHAPTER IV– DUTIES AND RESPONSIBILITIES OF CASE MANAGERS FOR PROTECTION OF CHILDREN UNDER THE AGE OF CRIMINAL RESPONSIBILITY</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Appointment of the case manager for protection of children under age of criminal responsibility</b></p> <p>1. A case manager shall be assigned for each child, who shall be an employee of the CSW of the respective municipality where the child resides or is located.</p> <p>2. After evaluating the case, the case manager may establish partnerships with governmental and non-governmental organizations, school, health and police institutions, the family and the community, in order to create the best opportunities for child protection and treatment, and work based on the principle set out in Article 7 of this Administrative Instruction.</p> <p>3. The case manager, during the preparation of the Child Protection Programme, shall inter alia:</p>	<p><b>POGLAVLJE IV- DUŽNOSTI I ODGOVORNOSTI RUKOVODIOCA SLUČAJA ZA ZAŠTITU DETETA ISPOD STAROSTI KRIVIČNE ODGOVORNOSTI</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Određivanje Rukovodioca slučaja za zaštitu deteta ispod starosti krivične odgovornosti</b></p> <p>1. Svakom detetu se određuje Rukovodilac slučaja, koji mora biti zaposlen u CSR odgovarajuće opštine gde dete ima prebivalište ili boravište.</p> <p>2. Nakon procene slučaja, Rukovodilac slučaja može uspostaviti partnerstvo sa vladinim i nevladinim organizacijama, školskim, zdravstvenim, policijskim, porodičnim i društvenim institucijama i zajednicom, u cilju stvaranja najboljih mogućnosti za zaštitu i tretman deteta, i da radi na osnovu principa utvrđenog u članu 7 ovog administrativnog uputstva.</p> <p>3. Rukovodilac slučaja tokom pripreme programa zaštite deteta mora između ostalog:</p>
--	---	--



<p>3.1. siguroj, që procedurat e aplikuara t'i përshtatën nevojave të veçanta të fëmijëve;</p> <p>3.2. krijojë dosje dhe të plotësojë të gjitha format e nevojshme profesionale të punës, lidhur me rastin e referuar;</p> <p>3.3. krijoj ekip pune, sipas vlerësimit të rrethanave në QPS, për mbrojtje dhe trajtim adekuat të fëmijës.</p> <p>4. Gjithashtu, për secilin rast të referuar të fëmijës duhet të merren parasysh këto çështje:</p> <p>4.1. vlerësimi fillestar i rastit bëhet brenda njëzet e katër (24) orësh pas caktimit të Menaxherit të Rastit.</p> <p>4.2. Menaxheri i Rastit dhe ndihmësi i tij sipas nevojës caktohen brenda ditës së njëjtë të referimit;</p> <p>4.3. Menaxheri i Rastit nuk duhet të ngarkohet me më shumë se gjashtë (6) raste aktive në të njëjtën kohë të trajtimit të fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale.</p>	<p>3.1. ensure that the procedures applied are tailored to the specific needs of the child;</p> <p>3.2. create a file and complete all necessary professional forms of work related to the referred case;</p> <p>3.3. set up a working team, according to the circumstances in the CSW, for adequate protection and treatment of the child.</p> <p>4. In addition, the following issues shall be considered for each referred case:</p> <p>4.1. the initial assessment of the case shall be made within twenty-four (24) hours of the appointment of the case manager.</p> <p>4.2. The case manager and his/her assistant as needed shall be assigned within the same referral day;</p> <p>4.3. The case manager shall not be charged with more than six (6) active cases at a time of children under the age of criminal responsibility.</p>	<p>3.1. osigurati da primenjeni postupci budu prilagođeni posebnim potrebama dece;</p> <p>3.2. stvara dosije i popunjava sve potrebne stručne obrasce rada, vezano za navedeni slučaj;</p> <p>3.3. osnovati radnu grupu, prema proceni okolnosti u CSR-u, za zaštitu i adekvatan tretman deteta.</p> <p>4. Takođe, za svaki naveden slučaj detetu, treba uzeti u obzir sledeća pitanja:</p> <p>4.1. početna procena slučaja vrši se u roku od dvadeset četiri (24) sata nakon određivanja Rukovodioca slučaja.</p> <p>4.2. Rukovodilac slučaja i njegov pomoćnik po potrebi se određuju u istom danu upućivanja;</p> <p>4.3. Rukovodilac slučaja neće biti opterećen sa više od šest (6) aktivnih slučajeva istovremeno tokom tretmana dece ispod starosti krivične odgovornosti.</p>
--	---	---

<p>5. Për secilin rast të vlerësuar në nevojë për kujdestari, Menaxheri i Rastit cakton një kujdestar të përkohshëm brenda një dite nga vlerësimi fillestar.</p> <p>6. Për secilin fëmijë duhet hartuar programin e mbrojtjes, ngase secili fëmijë është unik.</p> <p>7. Menaxheri i Rastit është përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë procesit dhe çdo rast duhet të trajtohet me një qasje shumëdimensionale dhe jo të izoluar.</p> <p>8. Çdo rast duhet trajtuar sipas veçantisë së tij dhe pa paragjykime dhe çdo vendim duhet të përcillet me analiza dhe hulumtime përkatëse me të gjithë partnerët dhe gjithnjë me pjesëmarrjen e fëmijës, prindit ose kujdestarit.</p> <p>9. Menaxheri i rastit duhet të bashkëpunoj me fëmijën, prindin ose kujdestarin gjatë përgatitjes së Programit të Mbrojtjes së Fëmijës.</p> <p>10. Gjithnjë duhet marrë parasysh mendimet e familjes për fëmijën dhe të bëhet përfshirja e fëmijës në të gjitha fazat.</p>	<p>5. For each case assessed to be in need of custody, the case manager shall designate a temporary guardian within one day of the initial assessment.</p> <p>6. A Child Protection Programme should be developed for each child, as each child is unique.</p> <p>7. The case manager shall be responsible for the smooth running of the entire process and each case should be treated with a multidimensional, non-isolated approach.</p> <p>8. Each case shall be treated in its own way and without prejudice, and any decision shall be followed by an appropriate analysis and research with all partners and always with the participation of the child, parent or guardian.</p> <p>9. The case manager shall cooperate with the child, parent or guardian during the preparation of the Child Protection Programme.</p> <p>10. The family's thoughts on the child and the child's involvement in all stages shall always be taken into account.</p>	<p>5. Za svaki slučaj procenjen da mu treba starateljstvo, Rukovodilac slučaja određuje privremenog staratelja u roku od jednog dana od početne procene.</p> <p>6. Za svako dete treba izraditi program zaštite, jer svako dete je jedinstveno.</p> <p>7. Rukovodilac slučaja je odgovoran za nesmetani tok celog procesa i svaki slučaj treba da se tretira sa više-dimenzionalnim, ne-izoliranim pristupom.</p> <p>8. Svaki slučaj treba tretirati prema svojoj posebnosti i bez predrasuda, a svaka odluka treba biti praćena odgovarajućim analizama i istraživanjima sa svim partnerima i uvek uz učešće deteta, roditelja ili staratelja.</p> <p>9. Rukovodilac slučaja treba da saraduje sa detetom, roditeljem ili starateljkom tokom pripreme programa zaštite deteta.</p> <p>10. Uvek treba uzeti u obzir mišljenja porodice o detetu i uraditi uključivanje deteta u svim fazama.</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Kualifikimi profesional i Menaxherit të Rastit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Professional qualification of the case manager</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Profesionalna kvalifikacija Rukovodioca slučaja</b></p>
<p>1. Menaxheri i rastit, përgjegjës për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale, përveç kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Ligjin përkatës për Shërbime Sociale dhe Familjare, duhet:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. të ketë së paku një (1) vit përvojë pune nga fusha relevante, që ndërlidhet me punën me fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. të ndjek trajnime të certifikuara për çdo vit nga fusha relevante, që ndërlidhet me punën me fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. të jetë i trajnuar posaçërisht për t'u marrë me fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. të jetë i licencuar në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.</p>	<p>1. The case manager responsible for the protection and treatment of children under the age of criminal responsibility, in addition to the criteria and conditions set forth in the relevant Law on Social and Family Services, shall:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. have at least one (1) year of work experience in a relevant field related to working with children under the age of criminal responsibility;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. attend certified training each year in the relevant field related to working with children under the age of criminal responsibility;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. be specially trained to deal with children under the age of criminal responsibility;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. be licensed in the field of social and family services.</p>	<p>1. Rukovodilac slučaja odgovoran za zaštitu i tretman dece ispod starosti krivične odgovornosti, osim kriterijuma i uslova utvrđenih u dotičnom Zakonu o socijalnim i porodičnim uslugama, mora:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. imati najmanje jednu (1) godinu radnog iskustva u dotičnu oblast koja se odnosi na rad sa decom ispod starosti krivične odgovornosti;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. da svake godine pohađa sertifikovane obuke iz odgovarajuće oblasti koja se odnosi na rad sa decom ispod starosti krivične odgovornosti;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. biti posebno obučen da se bavi decom ispod starosti krivične odgovornosti;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. biti licenciran u oblasti socijalnih i porodičnih usluga.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Të dhënat lidhur më fëmijën</b></p> <p>1. Menaxheri i rastit, përkujdeset, që pa vonesë të siguroj të dhënat për fëmijën, bazuar në:</p> <p>1.1. Gjendjen mendore dhe fizike;</p> <p>1.2. Aftësinë e komunikimit, inteligjencën;</p> <p>1.3. Vështirësitë në kuptimin e gjërave (nëse ka);</p> <p>1.4. Anamneza sociale dhe mjekësore.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>Data about the child</b></p> <p>1. The case manager shall, without delay, gather the following data about the child:</p> <p>1.1. Mental and physical condition;</p> <p>1.2. Communication skills, intelligence;</p> <p>1.3. Comprehension difficulties (if any);</p> <p>1.4. Social and medical anamnesis.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Podaci o detetu</b></p> <p>1. Rukovodilac slučaja se stara da bez odlaganja obezbedi podatke o detetu, na osnovu:</p> <p>1.1. mentalnog i fizičkog stanja;</p> <p>1.2. veštine komuniciranja, inteligencija;</p> <p>1.3. poteškoća u razumevanju stvari (ako postoje);</p> <p>1.4. socijalne i medicinske anamneze.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b> <b>Partneriteti për mbrojtjen e fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale</b></p> <p>1. Menaxheri i rastit mbledhë informacionin, që përfshin, por nuk kufizohet në rezultate shkollore, sjellje në shkollë dhe komunitet, gjendje familjare, përfshirë historinë e përvojave jo të mira gjatë fëmijërisë.</p> <p>2. Pas vlerësimit të rastit, Menaxheri i Rastit krijon partneritet me institucionet përkatëse shkollore, shëndetësore,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 29</b> <b>Partnership of protection of children under the age of criminal responsibility</b></p> <p>1. The case manager shall collect information including but not limited to school results, school and community behaviour, family status, including the history of bad childhood experiences.</p> <p>2. After assessing the case, the Case Manager shall establish partnerships with the relevant school, health and police institutions, the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 29</b> <b>Partnerstvo za zaštitu deteta ispod starosti krivične odgovornosti</b></p> <p>1. Rukovodilac slučaja prikuplja informacije koje uključuju, ali nisu ograničene na školske rezultate, ponašanje u školi i zajednici, porodično stanje, uključujući istoriju loših iskustava tokom detinjstva.</p> <p>2. Nakon procene slučaja, Rukovodilac slučaja uspostavlja partnerstvo sa odgovarajućim školskim, zdravstvenim,</p>

<p>policore, me familjen dhe komunitetin, në mënyrë që të krijohen mundësi sa më të mira për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës.</p> <p>3. Të gjitha institucionet dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, duhet të angazhohen, që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legislative dhe administrative përkatëse dhe bashkëpunojnë me Menaxherin e Rastit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit për fëmijën nën moshën e përgjegjesisë penale</b></p> <p>1. Menaxheri i rastit paraqet rastin e fëmijës në Tryezën multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve.</p> <p>2. Në Tryezën multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve përfshihen profesionistët e ndryshëm nga institucionet e ndryshme dhe njëkohësisht</p>	<p>family and the community in order to create the best opportunities for child protection and treatment.</p> <p>3. All child protection institutions and professionals shall be committed to providing the child with the protection and care necessary for his or her well-being, having regard to the rights and duties of his or her parents, legal guardians or of other persons legally responsible for him or her and, to this end, they shall take all appropriate legislative and administrative measures and cooperate with the Case Manager.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Multidisciplinary roundtable for assistance in case management for children under the age of criminal responsibility</b></p> <p>1. The case manager shall present the child's case to the multidisciplinary roundtable for assistance in case management.</p> <p>2. The multidisciplinary roundtable for assistance in case management shall consist of professionals from different institutions and the parent or guardian when this is in the best interests of the child.</p>	<p>policijskim institucijama, sa porodicom i zajednicom u cilju stvaranja najboljih mogućnosti za zaštitu i tretman deteta.</p> <p>3. Sve institucije i stručnjaci za zaštitu deteta trebaju se angažovati kako bi obezbedili detetu potrebnu zaštitu i brigu za dobrobit istog, imajući u vidu prava i dužnosti njegovih roditelja, zakonskih staratelja ili drugih osoba koje su zakonski odgovorne za to i u tom cilju preduzimaju sve odgovarajuće zakonodavne i administrativne mere i sarađuju sa Rukovodiocem slučaja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Multi-disciplinarni okrugli sto za pomoć u upravljanju slučaja za dete ispod starosti krivične odgovornosti</b></p> <p>1. Rukovodilac slučaja prijavi slučaj deteta u Multi-disciplinarnom okruglom stolu za pomoć u upravljanju slučajevima.</p> <p>2. U multi-disciplinarnom okruglom stolu o upravljanju slučajevima uključuju se razni stručnjaci iz različitih institucija i istovremeno na ove stolove se uključuju i</p>
--	---	--

<p>në këto tryeza përfshihen edhe prindi apo kujdestari dhe kur është në interesin më të mirë të fëmijës.</p> <p>3. Procedurat e punës, në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve, të udhëhequra nga Menaxheri i Rastit, në koordinim dhe bashkëveprim me strukturat dhe shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës, veprojnë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p><b>KAPITULLI V- PROGRAMI I MBROJTJES SË FËMIJËS NËN MOSHËN E PËRGJEGJËSISË PENALE</b></p> <p><b>Neni 31</b> <b>Programi i Mbrojtjes së Fëmijës</b></p> <p>1. Menaxheri i rastit, i caktuar nga Organi i kujdestarisë, në bashkëpunim me institucionet dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, si dhe sipas nevojës dhe rastit specifik në bashkëpunim me të gjitha njësitë tjera, të mandatuara për mbrojtjen e fëmijëve, hartojnë Programin e Mbrojtjes së fëmijës, i cili përmban edhe propozimin për masën e mbrojtjes, kur është e nevojshme.</p>	<p>3. Multidisciplinary roundtables for assistance in case management led by the Case Manager, in coordination and interaction with the structures and services responsible for child protection, shall operate pursuant to the relevant legislation in force.</p> <p><b>CHAPTER V- PROTECTION PROGRAMME FOR CHILDREN UNDER THE AGE OF CRIMINAL RESPONSIBILITY</b></p> <p><b>Article 31</b> <b>Child Protection Programme</b></p> <p>1. The case manager designated by the Guardianship Authority shall, in cooperation with child protection institutions and professionals, and as appropriate and specific to the case, with all other units with child protection competences, draft a Child Protection Programme, including a proposal for protection measures, where appropriate.</p>	<p>roditelj ili staratelj i kada je to u najboljem interesu deteta.</p> <p>3. Radni postupci, na multi-disciplinarnim stolovima za pomoć u upravljanju slučajevima, vođeni od Rukovodioca slučaja, u koordinaciji i interakciji sa strukturama i službama odgovornim za zaštitu deteta, deluju u skladu sa relevantnim važećim zakonodavstvom.</p> <p><b>POGLAVLJE V - PROGRAM ZAŠTITE DETETA ISPOD STAROSTI KRIVIČNE ODGOVORNOSTI</b></p> <p><b>Član 31</b> <b>Program zaštite deteta</b></p> <p>1. Rukovodilac slučaja, određen od Organa starateljstva, u saradnji sa institucijama i profesionalcima za zaštitu deteta, a po potrebi i specifičnom slučaju u saradnji sa svim ostalim jedinicama ovlašćenim za zaštitu deteta, izrade program zaštite deteta, što takođe uključuje i predlog za meru zaštite, kada je to potrebno.</p>
--	---	--

<p>2. Programi i Mbrojtjes së fëmijës përmban, përveç masave të mbrojtjes, edhe ndërhyrjet e tjera të nevojshme, që realizojnë respektimin dhe lehtësojnë qasjen e fëmijës në të drejtat e tij, si dhe shërbimet sociale apo shërbime të tjera të nevojshme, në bazë të nevojës së identifikuar gjatë vlerësimit të rastit.</p> <p>3. Programi i Mbrojtjes së Fëmijës përmban, sipas rastit, masat për mbrojtjen dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rastet kur fëmija është në rrezik për abuzim, dhunë, neglizhim e shfrytëzim dhe ndihmën mjekësore, shërbimin psikologjik, social apo çdo shërbim tjetër të nevojshëm rehabilitues apo riintegruues, sipas nevojës së identifikuar gjatë vlerësimit të rastit, si edhe aktivitete edukative, mësimore e argëtuese për fëmijën, masat për riaftësim prindëror, programet e mbështetjes dhe ndihmës për prindin, kujdestarin dhe anëtarët e ngushtë të familjes.</p> <p>4. Të gjitha masat dhe shërbimet e ofruara në kuadër të Programit të Mbrojtjes së Fëmijës ofrohen falas.</p>	<p>2. The Child Protection Program shall include, in addition to protection measures, other necessary interventions to ensure respect for and facilitate the child's access to his or her rights, as well as social services or other necessary services, as appropriate, identified during the case assessment.</p> <p>3. The Child Protection Programme shall include, where appropriate, measures for protection and immediate intervention in cases where the child is at risk of abuse, violence, neglect and exploitation, and medical assistance, psychological and social care or any other necessary rehabilitation or reintegration services, based on the needs identified during case, as well as educational, learning and entertainment activities for the child, parental rehabilitation measures, and support and assistance programs for the parent, guardian and close family members.</p> <p>4. All measures and services under the Child Protection Programme shall be provided free of charge.</p>	<p>2. Program zaštite deteta pored mera zaštite, sadrži i drugih potrebnih intervencija koje realizuju poštovanje i olakšavaju pristup deteta svojim pravima kao i socijalne usluge ili druge neophodne usluge, na osnovu potreba utvrđenim tokom procene slučaja.</p> <p>3. Program zaštite deteta sadrži, prema slučaju, mere za neposrednu zaštitu i intervenciju u slučajevima kada detetu preti opasnost od zlostavljanja, nasilja, zanemarivanja, eksploatacije i medicinske pomoći, psihološke, socijalne ili bilo koje druge neophodne usluge za rehabilitaciju ili reintegraciju, prema potrebi utvrđene tokom procene slučaja kao i obrazovne, vaspitne i zabavne aktivnosti za dete, mere za roditeljsko osposobljavanje, programe podrške i pomoći roditelja, staratelja i članovima uže porodice.</p> <p>4. Sve mere i usluge pružene u okviru Programa zaštite deteta pružaju se besplatno.</p>
---	---	---

<p align="center"><b>Neni 32</b> <b>Parimet dhe standardet e përgjithshme për përgatitjen e Programit të Mbrojtjes së Fëmijës</b></p>	<p align="center"><b>Article 32</b> <b>General principles and standards in Child Protection Programme development</b></p>	<p align="center"><b>Član 32</b> <b>Opšti principi i standardi za pripremu programa zaštite deteta</b></p>
<p>1. Programi i Mbrojtjes së Fëmijës duhet të planifikohet dhe zhvillohet në bazë të analizave dhe hulumtimeve, të monitorohet dhe të jetë i akorduar nga të gjitha institucionet.</p> <p>2. Shkëmbimi i informacioneve, përvojës dhe ekspertizave të arritura me anë të projekteve, programeve, praktikave dhe iniciativave të lidhura me fëmijën duhet të intensifikohen në të gjitha nivelet.</p> <p>3. Bashkëpunimi ndër komunal në lidhje me veprat penale të kryera nga fëmijët, duhet të zhvillohet dhe forcohet.</p> <p>4. Menaxheri i rastit përgatit Programin e Mbrojtjes së Fëmijës, duke u bazuar në parimet dhe standardet e mëposhtme:</p> <p>4.1. interesi më i mirë i fëmijës të jetë gjithmonë në konsideratë mbizotëruese;</p> <p>4.2. mbrojtja e integritetit personal të fëmijës;</p>	<p>1. The Child Protection Programme shall be planned and developed based on analysis and research, be monitored and agreed upon by all institutions.</p> <p>2. The exchange of information, experience and expertise gained through child-related projects, programs, practices and initiatives shall be intensified at all levels.</p> <p>3. Inter-municipal cooperation in relation to offenses committed by children shall be developed and strengthened.</p> <p>4. The case manager shall prepare the Child Protection Programme based on the following principles and standards:</p> <p>4.1. the best interests of the child shall always be taken into consideration;</p> <p>4.2. protecting the child's personal integrity;</p>	<p>1. Program zaštite deteta treba planirati i odvijati na osnovu analiza i istraživanja, da se prati i bude dogovoren od svih institucija.</p> <p>2. Razmena informacija, iskustva i ekspertiza stečenih putem projekata, programa, praksi i inicijativa vezane za dete treba intenzivirati na svim nivoima.</p> <p>3. Treba razviti i ojačati međuopštinsku saradnju u vezi sa krivičnim delima koja deca izvrše.</p> <p>4. Rukovodilac slučaja priprema program zaštite deteta na osnovu sledećih principa i standarda:</p> <p>4.1. najbolji interes deteta uvek da bude preovladajuća briga;</p> <p>4.2. zaštita ličnog integriteta deteta;</p>



<p>4.3. mbrojtja dhe respektimi i lirisë së besimit të fëmijës;</p> <p>4.4. vlerësimi individual i nevojave të fëmijës, në veçanti, duke marr parasysh:</p> <p>4.4.1. personalitetin dhe pjekurinë e fëmijës, gjendjen ekonomike, sociale dhe familjare të fëmijës, duke përfshirë mjedisin jetësor dhe çdo specifikë të fëmijës, e cila ndërlihet me aftësitë e të mësuarit dhe të komunikimit;</p> <p>4.4.2. karakteristikat dhe rrethanat individuale të rastit të fëmijës;</p> <p>4.4.3. ndjeshmërinë e rastit dhe masat specifike, që mund të merren për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës.</p>	<p>4.3. protecting and respecting the child's freedom of religion;</p> <p>4.4. individual assessment of the child's needs, in particular, taking into account:</p> <p>4.4.1. the child's personality and maturity, the child's economic, social and family situation, including the child's environment and any characteristic related to the child's learning and communication skills;</p> <p>4.4.2. the individual characteristics and circumstances of the child's case;</p> <p>4.4.3. the case sensitivity and specific measures that can be taken to protect and treat the child.</p>	<p>4.3. zaštita i poštovanje slobode verovanja deteta;</p> <p>4.4. pojedinačna procena potreba deteta, naročito uzimajući u obzir:</p> <p>4.4.1. ličnost i zrelost deteta, ekonomsko, socijalno i porodično stanje deteta, uključujući okruženje i bilo koje specifičnosti deteta vezano za sposobnost učenja i komuniciranja;</p> <p>4.4.2. pojedinačne karakteristike i okolnosti slučaja deteta;</p> <p>4.4.3. osetljivost slučaja i posebne mere koje se mogu preduzeti radi zaštite i tretmana deteta.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Përmbajtja e Programit të Mbrojtjes së Fëmijës</b></p> <p>1. Programi i Mbrojtjes së Fëmijës, duhet të përmbajë së paku:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Bazën e të dhënave lidhur me rastin e referuar;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Planin individual të shërbimeve të ofruara;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Procesin e intervistimit të fëmijës;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Procesin e konsultimit dhe të informimit.</p> <p>2. Programi i Mbrojtjes së Fëmijës, hartohet me një qasje unike, duke u bazuar në rastet specifike, sipas nevojave të veçanta të fëmijës, dhe në pajtim me format standarde profesionale të punës të përcaktuara nga Ministria.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Contents of the Child Protection Programme</b></p> <p>1. The Child Protection Programme shall contain at least:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. The database regarding the case referred;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. The individual plan of services provided;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. The child interviewing process;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. The consultation and information process.</p> <p>2. The Child Protection Programme shall be compiled with a unique approach, based on the specific cases and the specific needs of the child, and in accordance with the standard and professional forms of work stipulated by the Ministry.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Sadržaj Programa za zaštitu deteta</b></p> <p>1. Program za zaštitu deteta treba najmanje da sadrži:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Bazu podataka u vezi sa navedenim slučajem;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Individualni plan pruženih usluga;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Proces intervjuisanja deteta;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.4. Proces konsultacija i informisanja.</p> <p>2. Program za zaštitu deteta, treba izraditi jedinstvenim pristupom, zasnovajući se na specifičnim slučajevima, prema posebnim potrebama deteta, i u skladu sa standardnim profesionalnim oblicima rada utvrđenim od strane Ministarstva.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Baza e të dhënave lidhur me rastin e referuar</b></p> <p>1. Për secilin rast të referuar Menaxher i Rastit vendos të dhënat në</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Database references of referred cases</b></p> <p>1. For each case referred, the case manager shall enter the data in the database at the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Baza podataka u vezi sa upućenim slučajem</b></p> <p>1. Za svaki upućeni slučaj Rukovodilac slučaja unosi podatke u bazu podataka</p>

<p>bazën e të dhënave më së largu pesë (5) ditë nga dita e referimit fillestar.</p> <p>2. Baza e të dhënave duhet të përditësohet sipas rastit dhe nevojës.</p> <p>3. Baza e të dhënave duhet të përfshij, së paku:</p> <p>3.1.Të dhënat personale të fëmijës;</p> <p>3.2.Specifikat e rastit të referuar;</p> <p>3.3.Masat, të cilat i ofrohen fëmijës për mbrojtje dhe trajtim.</p> <p>3.4.Të dhëna tjera, të cilat konsiderohen të rëndësishme për rastin e referuar.</p> <p>4. Në bazën e të dhënave, sipas këtij neni, duhet të kenë qasje vetëm personat e autorizuar lidhur me rastin e referuar.</p>	<p>latest five (5) days from the date of the initial referral.</p> <p>2. The database shall be updated as and when needed.</p> <p>3. The database shall include, at least:</p> <p>3.1. personal information of the child;</p> <p>3.2. characteristics of the case referred;</p> <p>3.3. protection and treatment measures provided to the child;</p> <p>3.4. other information that is considered relevant to the case referred.</p> <p>4. The database, according to this article, shall be accessible only to authorized persons regarding the referred case.</p>	<p>najkasnije pet (5) dana od dana početnog upućivanja.</p> <p>2. Bazu podataka treba ažurirati po slučaju i potrebi</p> <p>3. Baza podataka treba najmanje da sadrži:</p> <p>3.1. Lične podatke deteta;</p> <p>3.2. Specifičnosti upućenog slučaja;</p> <p>3.3. Mere, koje se pružaju detetu za zaštitu i tretman;</p> <p>3.4. Ostale podatke koji se smatraju važnim za navedeni slučaj.</p> <p>4. Baza podataka, prema ovom članu, treba da bude dostupna samo ovlašćenim licima u vezi sa navedenim slučajem.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Plani individual i shërbimeve</b></p> <p>1. Menaxheri i rastit, në bashkëpunim dhe koordinim me prindin apo kujdestarin dhe familjen, kur një gjë e tillë është e mundur, siguron që nevojat specifike të fëmijës në</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Individual plan of services</b></p> <p>1. The case manager shall, in cooperation and coordination with the parent or guardian and family, when this is possible, ensure that the child's specific needs related to his/her</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Individualni plan usluga</b></p> <p>1. Rukovodilac slučaja, u saradnji i koordinaciji sa roditeljem ili starateljem i porodicom, kada je to moguće, osigurava da se detetove specifične potrebe koje su vezane</p>

<p>lidhje me mbrojtjen, arsimimin, gjendjen shëndetësore, integrimin social të fëmijës, të merren parasysh gjatë shqyrtimit të rastit të referuar.</p> <p>2. Vlerësimi individual, në veçanti, merr parasysh personalitetin dhe pjekurinë e fëmijës, gjendjen ekonomike dhe shëndetësore, sociale dhe familjare të fëmijës.</p> <p>3. Shtrirja dhe detajet e vlerësimit individual mund të ndryshojë varësisht nga rrethanat e rastit, masat që mund të merren ndaj fëmijës.</p> <p>4. Për secilin rast, më së largu tri (3) ditë pas vlerësimit final, Menaxheri i rastit harton planin individual të shërbimeve, sipas nevojës, duke përfshirë mendimin e profesionistëve.</p> <p>5. Plani individual i shërbimeve duhet të ketë qasje unike për punën në raste dhe të jetë specifik dhe të përmbaj detajet e aktiviteteve, të cilat janë të përfshira në ofrimin e shërbimit si:</p> <p>5.1. Identifikimi i rastit të referuar;</p> <p>5.2. Pranimi i rastit të referuar;</p> <p>5.3. Vlerësimi i rastit të referuar;</p>	<p>protection, education, health, and social integration are taken into account when considering the referred case.</p> <p>2. Individual assessment shall, in particular, take into account the child's personality and maturity, and economic, health, social and family situation.</p> <p>3. The scope and details of the individual assessment may vary depending on the circumstances of the case and the measures that may be taken in relation to the child.</p> <p>4. In each case, at the latest three (3) days after the final assessment, the case manager shall draft an individual plan of services as appropriate, including the opinion of professionals.</p> <p>5. The individual plan of services shall apply a unique approach to work in cases and be specific and include details of activities that are involved in service delivery such as:</p> <p>5.1. Identification of the referred case;</p> <p>5.2. Acceptance of the referred case;</p> <p>5.3. Assessment of the referred case;</p>	<p>za zaštitu, obrazovanje, zdravstveno stanje i socijalnu integraciju deteta, uzimaju u obzir prilikom razmatranja navedenog slučaja.</p> <p>2. Individualna procena, posebno, uzima u obzir ličnost i zrelost deteta, ekonomsku i zdravstvenu, socijalnu i porodičnu situaciju deteta.</p> <p>3. Obim i detalji individualne procene mogu varirati u zavisnosti od okolnosti slučaja i mera koje se mogu preduzeti protiv deteta.</p> <p>4. Za svaki slučaju, najkasnije tri (3) dana nakon konačne procene, Rukovodilac slučaja će izraditi individualni plan usluga, prema potrebi, uključujući mišljenje profesionalaca.</p> <p>5. Individualni plan usluga trebalo bi da ima jedinstven pristup radu na slučajevima i biti specifičan i sadržavati detalje aktivnosti koji su uključeni u pružanju usluga kao što su:</p> <p>5.1. Identifikacija upućenog slučaja;</p> <p>5.2. Prihvatanje upućenog slučaja;</p> <p>5.3. Procena upućenog slučaja;</p>
--	--	--

<p>5.4. Planifikimi i rastit të referuar;</p> <p>5.5. Asistenca e posaçme e ofruar;</p> <p>5.6. Mbështetja e rregullore dhe mbikëqyrja;</p> <p>5.7. Angazhimi/lidhja me fëmijën dhe familjen.</p> <p>6. Menaxheri i rastit është përgjegjës, që plani individual i shërbimeve për çdo fëmijë të:</p> <p>6.1. shqyrtohet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e hartimit të tij.</p> <p>6.2. rishikohet dhe ndryshohet aty ku është e nevojshme së paku në çdo tre (3) muaj pas shqyrtimit të parë.</p> <p>7. Menaxheri i rastit, në kuadër të planit individual të shërbimeve, ndër të tjera, mban evidencë edhe për:</p> <p>7.1. llojin e shërbimit;</p> <p>7.2. ofruesin e shërbimit;</p> <p>7.3. lokacionin e shërbimit të ofruar;</p>	<p>5.4. Planning of the referred case;</p> <p>5.5. Special assistance provided;</p> <p>5.6. Regular support and supervision;</p> <p>5.7. Engagement/connection with the child and family.</p> <p>6. The case manager shall be responsible for ensuring that the individual plan of services for each child is:</p> <p>6.1. reviewed within thirty (30) days of its drafting.</p> <p>6.2. reviewed and amended where necessary at least every three (3) months after the first review.</p> <p>7. The case manager shall record in the individual plan of services inter alia:</p> <p>7.1. the service type;</p> <p>7.2. the service provider;</p> <p>7.3. the location of service provided;</p>	<p>5.4. Planiranje upućenog slučaja;</p> <p>5.5. Posebna pružena pomoć;</p> <p>5.6. Redovna podrška i nadzor;</p> <p>5.7. Angažovanje/veza sa detetom i porodicom.</p> <p>6. Rukovodilac slučaja je odgovoran da se individualni plan usluga za svako dete:</p> <p>6.1. razmotri u roku od trideset (30) dana od dana njegove izrade.</p> <p>6.2. pregleda i izmeni gde je potrebno najmanje svakih (3) meseca nakon prvog razmatranja.</p> <p>7. Rukovodilac slučaja, u okviru individualnog plana usluga, između ostalog, vodi evidenciju i o:</p> <p>7.1. vrstama usluga;</p> <p>7.2. pružaocu usluge;</p> <p>7.3. lokaciji pružene usluge;</p>
--	--	--

<p>7.4. periudhën kohore.</p> <p>8. Çdo fëmijë, që është në gjendje të shprehë dëshirat dhe mendimin e vet, përfshihet në hartimin e Programit të Mbrojtjes së Fëmijës.</p> <p>9. Plani individual i shërbimeve përmban një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga prindi ose kujdestari dhe fëmija, kur një gjë e tillë është e mundur, me të cilën deklaratë obligohen për bashkëpunim në procesin e masave për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës.</p> <p>10. Secili shërbim i ofruar, duhet të ketë një broshurë informuese mbi shërbimet dhe të drejtat e fëmijës.</p>	<p>7.4. the time period.</p> <p>8. Every child who is able to express their wishes and opinion shall be involved in the drafting of the Child Protection Programme.</p> <p>9. The individual plan of services shall contain a written statement signed by the parent or guardian and the child, where possible, stating that they are required to cooperate in the process of child protection and treatment measures.</p> <p>10. Each service provided shall have a brochure on child services and rights.</p>	<p>7.4. vremenskom periodu.</p> <p>8. Svako dete, koje je u stanju da izrazi svoje želje i mišljenje, biće uključeno u izradi Programa za zaštitu deteta.</p> <p>9. Individualni plan usluga sadrži pismenu izjavu koju potpisuju roditelj ili staralac i dete, gde je to moguće, kojom se izjavom obavezuju za saradnju u procesu preduzimanja mera za zaštitu i tretman deteta.</p> <p>10. Svaka pružena usluga mora imati informativnu brošuru o dečijim uslugama i pravima.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 36</b> <b>Procesi i konsultimit dhe informimit</b></p> <p>1. Menaxheri i rastit me qëllim të koordinimit sa ma të mirë për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës organizon së paku:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Tri (3) takime këshilluese për fëmijën me prindin ose kujdestarin brenda tre (3) muajve të referimit fillestar;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 36</b> <b>Consultation and information process</b></p> <p>1. The case manager, with the aim of coordinating as best as possible the protection and treatment of the child, shall organize at least:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Three (3) counselling meetings for the child with the parent or guardian within three (3) months of the initial referral;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 36</b> <b>Proces konsultacija i informisanja</b></p> <p>1. Rukovodilac slučaja, sa ciljem što bolje koordinacije za zaštitu i tretman deteta organizuje najmanje:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Tri (3) konsultativna sastanka za dete sa roditeljem ili starateljem u roku od tri (3) meseca od početnog upućivanja;</p>

<p>1.2. Tri (3) takime këshilluese me specialistë të jashtëm brenda tre (3) muajve të referimit fillestar.</p> <p>2. Për secilin rast të fëmijës me sjellje asociale, trajtimi nga shërbimi do të zgjasë për aq kohë sa të vlerësohet nga Menaxheri i rastit, në konsultim me psikologun, prindin apo kujdestarin si dhe profesionistët tjerë të përfshirë në rast.</p> <p>3. Për secilin rast të fëmijës realizohet së paku nga një (1) vizitë monitoruese për çdo dy (2) muaj për gjatë periudhës së dytë gjashtë (6) mujore të trajtimit.</p> <p>4. Për secilin rast të referuar vendimi mbi ndërprerjen e trajtimit duhet të merret në konsultim me prindin, prindin adoptues ose kujdestarin dhe partnerët e ndërlidhur me rastin.</p>	<p>1.2. Three (3) counselling meetings with external specialists within three (3) months of the initial referral.</p> <p>2. In cases of a child with asocial behaviours, the service shall provide treatment for as long as it is deemed necessary by the Case Manager, in consultation with the psychologist, parent or guardian as well as other professionals involved in the case.</p> <p>3. At least one (1) monitoring visit shall be carried out in every case involving a child every two (2) months for the second six (6)-month period of the treatment.</p> <p>4. In each case referred, the decision to discontinue treatment shall be made in consultation with the parent, foster parent or guardian, and partners involved in the case.</p>	<p>1.2. Tri (3) konsultativna sastanka sa spoljnim specijalistima u roku od tri (3) meseca od početnog upućivanja.</p> <p>2. Za svaki slučaj deteta sa asocijalnim ponašanjem, tretman od strane službe će trajati koliko to bude ocenio Rukovodilac slučaja, u konsultaciji sa psihologom, roditeljem ili starateljem, kao i drugim profesionalcima uključenim u slučaju.</p> <p>3. Za svaki slučaj deteta realizuje se najmanje jedna (1) poseta svakih dva (2) meseca tokom drugog šestomesečnog (6) perioda lečenja.</p> <p>4. Za svaki upućeni slučaj odluku o prekidanju lečenja treba doneti u konsultaciji sa roditeljem, usvojiteljem ili starateljem i partnerima uključenim u slučaju.</p>
